

Marrëveshje Bashkëpunimi

ndërmjet
Avokatit të Popullit
dhe

Qendrës Shqiptare për Rehabilitimin e viktimave të Traumës dhe Torturës

Hyrje

Kjo marrëveshje përbën bazën ligjore të bashkëpunimit ndërmjet institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Shqipërisë (AP, në vazhdim) dhe Qendrës Shqiptare për Rehabilitimin e viktimave të Traumës dhe Torturës (QSHRT, në vazhdim) në kuadrin e angazhimit të përbashkët në përmbushje të Fushatës Kombëtare kundër Torturës, për respektimin efektiv të të drejtave themelore dhe legjislacionit për dënimin dhe parandalimin e torturës.

Kjo marrëveshje vjen në përputhje me nenin 30, paragrafi I i Ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, ndryshuar "PËR AVOKATIN E POPULLIT", i ndryshuar, Ligjin Nr. 9888, datë 10.3.2008, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim" të ndryshuar; si dhe me parimet e Konventës së OKB-së kundër Torturës dhe Dënimeve, a Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore, ose Degraduese (nënshkruar me Ligjin nr.7727, datë 30.06.1993, shpallur me dekretin nr. 592, datë 06.07.1993 të Presidentit të Republikës); Protokollit Opsional të kësaj Konvente si dhe të Konventës "Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut", nënshkruar më 13.07.1995/ ratifikuar e hyrë në fuqi më 02.10.1996).

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit të përfaqësueve titullarë të subjekteve të sipër-përmendura:

1. **Avokati i Popullit**, z. Igli Totozani, me seli në Blv. "Zhan D'Ark", Nr.2, Tiranë
2. **Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës**, Z. Adrian Kati, me seli në Rrugën "Kont Urani", Nr.10, Tiranë

Seksioni I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

Kjo marrëveshje ka si qëllim bashkëpunimin e dy institucioneve për mbrojtjen e të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve, në zbatim të kuadrit ligjor të lartpërmendur si dhe standarteve ndërkombëtare që lidhen me respektimin e të

drejtave dhe parandalimin e keqtrajtimeve dhe të torturës për personat që vuajnë dënimin.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllime të kësaj marrëveshje:

- a. Monitorim është procesi i mbledhjes, vëzhgimit dhe vlerësimit të të dhënave, rezultateve, funksioneve dhe ecurisë së zbatimit të kuadrit ligjor dhe institucional.
- b. ekipi monitorues është grupi i ekspertëve që marrin pjesë gjatë vizitave monitoruese, të profesioneve jurist, psikolog, punonjës social/edukator, dhe mjek, sipas kërkesave dhe parimeve të Protokollit Opsional në kuadër të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës.
- c. raporte monitorimi janë aktet administrative dhe dokumentuese që pasqyrojnë përmbushjen e misionit të ekipit të vlerësimit, sipas instrumentit standard të monitorimit.

Seksioni II

Bashkëpunimi dhe ndihma e ndërsjelltë

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

Në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, fushat e bashkëpunimit dhe ndihma e ndërsjelltë do të fokusohen në:

- a) ndërmarrjen e vizitave të përbashkëta monitoruese në të gjitha institucionet e vuajtjes së dënimit (burgje, paraburgim, komisariate policie, etj);
- b) ofrimin e ndihmës së ndërsjelltë me ekspertizë dhe staf mjekësor dhe psikosocial për mbarëvajtjen e monitorimit periodik të sistemit kombëtar për vuajtjen e dënimit
- c) propozime për ndryshime në legjislacion;
- d) propozime për ndryshime në strukturat organizative/institucionale;
- e) Respektimin e standarteve të etikës dhe të drejtat;
- f) Zbatimin efektiv të legjislacionit të BE-së dhe standarteve të OKB;

Neni 4

Monitorimi periodik i sistemit kombëtar penitensiar

- a) Njësia Kombëtare e Parandalimit të Torturës pranë AP në bashkëpunim me Qendrën shqiptare për rehabilitimin e traumës dhe torturës (QSHRT) do të vëzhgojnë rregullisht trajtimin e individëve, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, arrestimit ose burgosjes, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues;
- b) Mekanizmi Kombëtar i Parandalimit të Torturës pranë AP dhe Qendra shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës (QSHRT) bashkëpunojnë në paraqitjen e

rekomandimeve për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruës.

Neni 5

Format e tjera të asistencës

- a) Për aktivitetet e përbashkëta në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, apo çdo formë asistence/ këshillimi të ofruar në fushën e shëndetit mendor, ndihmës psikosociale dhe rehabilitimit, legjislacionit, Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës angazhohet të respektojë standartet dhe metodat më koherente që aplikohen kryesisht në BE dhe/ose lindin si detyrime shtetërore të Shqipërisë nga instrumente të së drejtës ndërkombëtare;
- b) Për realizimin e programit të monitorimeve, Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës si pjesë e rrjetit ndërkombëtar kundër torturës angazhon specialistë [mjekë, psikologë, punonjës socialë] të cilët ofrojnë përbushjen e kriterëve ndërkombëtare për mirëfunksionimin e MKP-së sipas kërkesave të Protokollit Opsional të Konvetnës kundër Torturës.
- c) Ndihma dhe bashkëpunimi profesional ofrohet mbi bazën e nevojave të identifikuara gjatë vizitave monitoruese dhe rasteve të evidentuara, duke respektuar parimin e ligjshmërisë, paanësisë, konfidencialitetit dhe etikës profesionale. Si rrjedhim, palët angazhohen në shkëmbimin e informacionit dhe ndihmesë reciproke në referimin e rasteve specifike të torturës të evidentuara gjatë vizitave monitoruese.

Seksioni III

Procesi i monitorimit të vazhdueshëm në bazë të legjislacionit të brendshëm dhe ndërkombëtar

Neni 6

Kalendari i monitorimeve

Si pjesë e respektimit të mandatit, fushës së veprimtarisë dhe normave ndërkombëtare që kërkojnë monitorimin dhe raportimin nga shoqëria civile për standartet e të drejtave në institucionet e dënimit në Shqipëri, Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës kryen veprimtari monitoruese sipas një kalendari të miratuar paraprakisht nga drejtori ekzekutiv.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje dhe në zbatim të detyrimeve ligjore të të dyja institucioneve, QSHRT dhe Avokati i Popullit bien dakord që të realizojnë një program të përbashkët vizitash/inspektimesh. Programi ndërtohet duke konsideruar një shpërndarje kohore dhe gjeografike që lejon realizimin korrekt të aktiviteteve, në kuadër të fushatës kombëtare për parandalimin e torturës, si dhe duke u kombinuar me planet vjetore të inspektimit të miratuara nga AP.

Programi zbatohet pasi është diskutuar në grupin e punës dhe ka marrë formë përfundimtare, pas nënshkrimit të Avokatit të Popullit, z. Igli Totozani dhe Drejtorit Ekzekutiv të QSHRT, z. Adrian Kati, dhe protokollimit të tij.

Neni 7

Standartet për monitorim, raportim dhe parandalim

- a) Standartet që do të vihen në zbatim nga Qendra shqiptare për rehabilitimin e traumës dhe torturës gjatë procesit të monitorimit, raportimit dhe parandalimit të keqtrajtimeve/torturës janë në bazë dhe për zbatim të konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, përkatësisht:
- i. Konventa e OKB-së kundër Torturës dhe Trajtimeve, ose Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore dhe Degraduese
 - ii. Konventa e OKB-së për Personat me Aftësi të kufizuar
 - iii. Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës
 - iv. Standardet përkatëse Minimale të OKB-së dhe Evropiane të Burgjeve
 - v. Protokollin Opsional në kuadër të zbatimit të Konventës kundër Torturës
 - vi. Konventa Evropiane për mbrotjen e të drejtave themelore të njeriut, me ratifikimin e saj me Ligjin nr. 8137, datë 1996 dhe me depozitimin e instrumentave të ratifikimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës më 2 tetor 1996

Seksioni IV: Burime dhe mjete

Neni 8

Mjete dhe pajisje logjistike

- a) Avokati i Populli dhe QSHRT-ja në zbatim të këtij bashkëpunimi, bien dakord të venë në dispozicion mjetet logjistike dhe specialistët me qëllim realizimin e suksesshëm të aktiviteteve të përbashkëta.
- b) Avokati i Popullit angazhohet të përfshijë ekspertizën e ofruar nga QSHRT, në rekomandimet e tij për sa është e mundur dhe të ndihmojë në adresimin e tyre për përmirësimin e trajtimit të të dënuarve në ambjentet e vuajtjes së dënimit, për garantimin e lirive dhe të drejtave themelore.

Seksioni V

Dispozitat e fundit

Neni 9

Hyrja në fuqi dhe zbatimi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi, pas nënshkrimit nga palët nënshkruese me dt ___/___/2013 dhe është e vlefshme për ___ vit(e).

Palët nënshkruese emërojnë përkatësisht:

Z. Sotiraq Nushi, drejtues i Njesisë së Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës pranë Avokatit të Popullit, dhe
zj. Erinda Bllaca, eksperte ligjore në Qendrën Shqiptare për Rehabilitimin e Viktimave të Traumës dhe Torturës
për ndjekjen e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Neni 11 – Dispozita te fundit

Kjo marrëveshje mund të rishikohet dhe amendohet në bazë të konsensusit ndërmjet palëve nënshkruese. Ndryshimet mund të bëhen me marrëveshje nga Palët nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.

Çdo mosmarrëveshje krijuar mbi interpretimin ose ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.

Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale, njëra për Qendrën Shqiptare të Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës dhe tjera për Avokatin e Popullit.

Avokati i Popullit

Igli TOTOZANI



Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës

Adrian KATI



Drejtor ekzekutiv

